



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2019

**PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 27.03.2019)*

*Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.*

*Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:14 dhe mbaroi në orën 13:07.*

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- |                           |                          |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Naureda Llagami</i> | <i>(kryetare)</i>        |
| <i>2. Maksim Qoku</i>     | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i>    | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>4. Medi Bici</i>       | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>5. Brunilda Kadi</i>   | <i>(anëtare)</i>         |
| <i>6. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>7. Ilir Toska</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>8. Alban Toro</i>      | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>9. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i>          |
| <i>10. Marçela Shehu</i>  | <i>(anëtare)</i>         |

*Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Erjon Muharremaj.*

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Specialist pranë institucionit.*
5. *Valbona Bako, Specialiste pranë institucionit.*
6. *Edlira Bako, Drejtoreshë e Drejtorisë Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë.*
7. *Përfaqësues të EURALIUS-it.*
8. *Përfaqësues të USAID-it.*
9. *Përfaqësuese e Komitetit Kombëtar të Helsinkit.*
10. *Përfaqësuese e OSBE-së.*
11. *Përfaqësues i ISP-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave, 28.02.2019 dhe 12.03.2019 nga anëtarët e Këshillit.
2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit Arben Zefi”.
3. Shqyrtimi i relacionit mbi dhënien e komenteve dhe kundërshtimeve për raportin e Shkollës së Magjistraturës për rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2019-2020, profili gjyqtar”.
4. Miratimi i projektvendimit “Për ndryshimin e vendimit nr. 47, datë 18.03.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.
5. Miratimi i projektvendimit “Për ndryshimin e vendimit nr. 35, datë 19.02.2019, të

Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

6. Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Flora Hasimi, për përfitimin e lejes së papaguar, për një periudhë 4-5 javore, nga ushtrimi i detyrës së gjyqtares, për shkaqe shëndetësore, duke filluar nga 5 prill 2019 deri më datë, jo më larg se 18 maj 2019.
7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.
8. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e anëtarit zëvendësues në Komisionin e Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.

***Naureda Llagami:*** Atëherë, përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen plenare të datës 27.03.2019. Janë prezent të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, përveç zotit Erjon Muharremaj, i cili për arsye pune është në një konferencë, ku përfaqëson Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Siç jeni vënë në dijeni, lidhur me rendin e ditës, sot në rendin e ditës janë përfshirë 8 çështje për t’u diskutuar dhe për t’u shqyrtuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Çështja e parë është: Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave, 28.02.2019 dhe 12.03.2019 nga Këshilli.

Çështja e dytë është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit **Arben Zefi**”.

Çështja e tretë është: Shqyrtimi i relacionit mbi dhënien e komenteve dhe

kundërshtimeve për raportin e Shkollës së Magjistraturës mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidateve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2019-2020, profili gjyqtar”.

Çështja e katërt lidhet me: Miratimin e projektvendimit “Për ndryshimin e vendimit 47, i datës 18.03.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e pestë është: Miratimi i projektvendimit “Për ndryshimin e vendimit nr. 35, datë 19.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Çështja e gjashtë është: Shqyrtimi i kërkesës së gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, **Flora Hasimi**, për përfitimin e lejes së papaguar, për një periudhë 4-5 javore, nga ushtrimi i detyrës së gjyqtares, për shkaqe shëndetësore.

Çështja e shtatë është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.

Çështja e tetë është: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e anëtarit zëvendësues në Komisionin e Përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”.

Atëherë, jemi dakord me rendin e ditës?

Dakord.

Atëherë, kalojmë tek çështja e parë që lidhet me miratimin e procesverbaleve të datës 28 shkurt dhe datës 12 mars nga ana e anëtarëve të Këshillit.

Jemi dakord për miratimin e procesverbaleve?

Të kalojmë në votim?

Kemi ndonjë koment? –Jo!

Kalojmë votim miratimin e procesverbaleve.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

*Albana Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Pro.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Medi Bici:* Pro.

*Naureda Llagami:* Dakord.

**Lidhur me çështjen** e dytë të projektvendimit “Për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak të dorëheqjes, së gjyqtarit Arben Zefi”, kjo çështje do të relatohet nga kryetari i Komisionit të zhvillimit të karrierës. Përpara se t’ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska, për relatin e projekt-aktit, doja të vë në dijeni anëtarët e Këshillit që jo më lart se dje pasdite, pasi ishte publikuar rendi i ditës për mbledhjen e sotme, ka ardhur një kërkesë drejtuar nga zoti Arben Zefi i cili i drejtohet anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nëpërmjet kësaj kërkesë ai ka shpjeguar, kërkon që të heqë dorë nga shqyrtimi i dorëheqjes nga statusi i magjistratit.

Për shqyrtimin e kësaj çështjeje, po ia kaloj fjalën zotit Ilir Toska.

**Ilir Toska:** Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur relacionin në lidhje me dorëheqjen e parashtruar nga gjyqtari Arben Zefi. Dorëheqja është depozituar edhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, bërë më datë 10 janar të vitit 2019. Kemi parashtruar faktet rreth kësaj çështjeje në një relacion shpjegues të hollësishëm me shkrim, legjislacionin që implikohet në këtë rast. Kemi parashtruar qëndrime të mbajtura nga institucionet e rivlerësimit. Kemi parashtruar edhe opinionet e dhëna nga dy misionet që asistojnë Këshillin (nga EURALIUS dhe USAID) dhe vlerësimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Nga ana e Komisionit nuk është pasur parasysh rrethana e re që ju relatuat pak më parë, pra faktin që ditën e djeshme, më datë 26 mars 2019, nga ana e zotit Zefi, është paraqitur përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor një kërkesë, përmes së cilës shprehet se, tërhiqet nga kërkesa për dorëheqje dhe kërkon nga ana jonë që të mos merret për shqyrtim dorëheqja e paraqitur prej tij në datën 10 janar të vitit 2019. Lidhur me këtë

moment të fundit, ne nuk kemi bërë ndonjë parashtrësë nga ana e Komisionit sepse ka qenë në kufijtë kohorë që ne nuk mund ta reflektonim një rrethanë të tillë. Nëse Këshilli konsideron që ne duhet të japim edhe një koment rreth rrethanës së re të parashtruar nga ana e zotit Zefi, Këshilli mund ta vendosë këtë gjë dhe ne të na jepni një kohë të shkurtër që ta reflektojmë këtë rrethanë dhe të japim edhe opinionin tonë rreth këtij momenti procedural.

Por gjithsesi, nëse do konsideroni që ne duhet të reflektojmë edhe këtë moment, konsideroni nga ana tjetër edhe faktin që gjyqtari, zoti Zefi, të paraqitet përpara Këshillit për të kuptuar qartësisht atë që ai ka referuar, qoftë duke parashtruar dorëheqjen, qoftë duke parashtruar edhe kërkesën për tërheqje nga dorëheqja, që të mos ngelet kjo çështje në një korrespondencë dokumentash, që nuk i dihet fundi tashmë. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Atëherë, si mendoni?

Do ta tërheqim këtë çështje nga rendi i ditës për t'i dhënë kohë?

**Ilir Toska:** Atëherë, unë mendoj që ta shtyjme. Nuk i bie që ta tërheqim. Ta shtyjme.

**Naureda Llagami:** Ta shtyjme.

**Ilir Toska:** Nëse do konsideroni që ne do bëjmë një raport shtesë edhe për kërkesën e paraqitur së fundi. Nëse konsideroni këtë gjë, okej! Konsideroni nga ana tjetër edhe këtë kërkesën që ne ju parashtrojmë, që zoti Zefi të paraqitet në seancë dëgjimore, të parashtrojë edhe verbalisht atë që ai ka menduar kur ka paraqitur të 2 kërkesat.

**Naureda Llagami:** E do njeri fjalën lidhur me sugjerimet e dhëna nga kryetari i Komisionit apo kalojmë në votim lidhur me propozimet konkrete që ai sugjeroi?

Jeni dakord me propozimet e bëra nga kryetari i Komisionit lidhur me shtyrjen e shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, me qëllim që nga ana e Komisionit të përgatitet një raport për kërkesën e re të paraqitur nga **Arben Zefi** dhe mundësia për t'u thirrur ai në një seancë dëgjimore përpara Këshillit?

Kalojmë në votim?

**Maksim Qoku:** Më duhet të them diçka.

Ne natyrisht kemi një procedurë ligjore për caktimin e rendit të ditës dhe vënien në dispozicion të materialeve, që afati më i mundshëm është 3 ditë përpara. Çka do të

thotë, e quaj të panevojshme të marrim në konsideratë kërkesën e futur vetëm dje, meqë rezulton që e ka sjellë vetëm dje, për heqjen dorë nga dorëheqje.

Në këtë këndvështrim, them që nuk kemi pse as ta shtyjme nga rendi i ditës, por të marrim në shqyrtim kërkesën e parë, por së dyti, nuk kemi pse të kërkojmë të intervistojmë apo të dëgjojmë atë, por sa kërkesa e tij është bërë me shkrim dhe është lehtësisht e kuptueshme. Kështu që në këtë aspekt, them që mos ta shtyjme. Ta shqyrtojmë rendin e ditës dhe të merremi me kërkesën e parë të subjektit kërkuar lidhur me dorëheqjen. Të gjykojmë direkt për statusin e këtij të fundit. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Mendim tjetër para se ta hedhim në votim?

**Brikena Ukperaj:** Unë kam diçka.

Në fakt, unë do të përkrah propozimin e kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për vetë faktin që, me të gjithë ecurinë e çështjes të zotit Arben Zefi, personalisht e vlerësoj të dyshimtë edhe shfaqjen e vullnetit të tij në momentin e parë kur ka bërë dorëheqjen. Sepse ne kemi një shfaqje vullneti për dorëheqje që është 4-5 rreshta, me bazë ligjore Aneksi G të Kushtetutës. Pastaj kemi të njëjtën ditë vendimin e shkarkimit. Pastaj na rezulton që më pas kemi edhe ankim nga subjekti i vlerësimit kur ai tashmë edhe pse ka dhënë dorëheqjen kërkon të ndryshojë vendimin e Komisionit dhe të konfirmohet në detyrë, pra kërkon që të jetë gjyqtar dhe nga ana tjetër, mbrëmë përsëri thotë që heq dorë nga dorëheqja. Për mendimin tim, vullneti i zotit Arben Zefi, për të hequr dorë që në momentin e parë kur e ka paraqitur kërkesën, është i dyshimtë. Prandaj mendoj që të diskutohet një nga zgjidhjet, ose ta trajtojmë përsëri Komisioni ose e përkrah edhe mendimin e kryetarit që mund ta thërrasim edhe në seancë dëgjimore.

**Naureda Llagami:** Atëherë, kalojmë në votim propozimin e bërë nga kryetari i Komisionit?

**Maksim Qoku:** Kundër.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Albana Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

*(Zonja Shehu nuk e ka pasur hapur mikrofonin në momentin e votimit. Sipas shënimeve të stenografes, zonja Shehu është dakord propozimit.)*

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin, në mbledhjen e ardhshme, pasi të hartohet relacioni me shpjegimet lidhur me kërkesën e bërë dhe të njoftohet zoti **Zefi** për seancën dëgjimore, Këshilli do kalojë në vendimmarrjen për çështjen konkrete.

**Kalojmë tek pika e tretë** e rendit të ditës, e cila lidhet me shqyrtimin e raportit mbi komentet dhe kundërshtimet për sa i përket raportit të Shkollës së Magjistraturës mbi rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, për vitin akademik 2019-2020, profili gjyqtar”.

Ashtu siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 17, datë 29.01.2019 ka shpallur vendet vakante për kandidatët gjyqtarë për vitin akademik 2019–2020. Pas këtij vendimi nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës në datë 31.01.2019 është vendosur që të bëhet publikimi i thirrjes për kandidime për pranimin në formimin fillestar. Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka miratuar përbërjen e Komisionit të Administrimit të Provimit dhe në datën e zhvillimit të provimit të pranimi, i cili sipas vendimit do të zhvillohet në datat respektive 23 dhe 25 prill 2019. Gjithashtu, në vendim është përcaktuar edhe periudha e regjistrimit për kandidatët në formimin fillestar, në përputhje me nenin 30 të ligjit 96/2016.

Në vijim të sa më sipër për gjatë periudhës 1 deri në 28 shkurt 2019, sekretaria shkencore për formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës ka pranuar aplikimet nga personat e interesuar për të marrë pjesë në provimin e pranimi. Gjatë periudhës së regjistrimit, këto persona që kanë shprehur interesin dhe kanë kryer procedurat e regjistrimit për të marrë pjesë në konkurs kanë qenë gjithsej në total 360 (*lapsus, pasi është 306*) (treqind e gjashtë), nga të cilët: 50 (pesëdhjetë) aplikues janë për kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë; 75 (shtatëdhjetë e pesë) aplikues për kandidatë për këshilltarë për ndihmës ligjorë dhe kandidatë për magjistratë; dhe 179 (njëqind e



shtatëdhjetë e nëntë) aplikues vetëm për kandidatë për magistratë (për gjyqtarë).

Për më shumë informacione, po ia kaloj kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Etikës, e cila ka hartuar projekt-raportin mbi komentet dhe kundërshtimet lidhur me listat që janë kualifikuar dhe skualifikuar nga Shkolla e Magistraturës për kandidatët të profilit magistrat.

**Brikena Ukperaj:** Atëherë, siç u relatua edhe nga Kryetarja e Këshillit, Shkolla e Magistraturës, në respektim të afatit ligjor, ka përcjellë në Këshillin e Lartë Gjyqësor materialet me listat paraprake të verifikimit paraprak të aplikantëve që plotësojnë sipas kriterëve të vendosura në ligj dhe në rregulloren e kësaj shkolle, kushtet për t'u pranuar në provimin e pranimit të trajnimit fillestar.

Shkolla në fakt, i është referuar kriterëve të nenit 28, të cilat janë shtjelluar më tej në rregulloren e Shkollës së Magistraturës, pikërisht nenin 10 të kësaj rregulloreje. Kompetencat e Këshillit në këtë fazë, janë ato të dhënies thjesht të sugjerimeve, komenteve ose kundërshtimeve mbi këtë listë ose këtë raport të përgatitur nga Shkolla e Magistraturës, komente të cilat i përcillen në një fazë më të mëvonshme përsëri Shkollës dhe është ajo që vendos për listën përfundimtare të aplikantëve që kualifikohen për t'u nënshtruar provimit të trajnimit, gjithmonë të profilit gjyqtar.

Nga materialet ka rezultuar që në lidhje me personat e kualifikuar, janë konkretisht 223 (dyqind e njëzet e tre) aplikantë. Nga verifikimi paraprak, ka rezultuar që ato janë të bazuar në kriterë, prandaj vlerësoj që në lidhje me këto aplikime të pranuar nuk mendoj që ka ndonjë koment, sugjerim apo kundërshtim.

Komentet dhe kundërshtimet ose sugjerimet i referohen pikërisht listës me 29 (njëzet e nëntë) aplikantë, të cilët janë skualifikuar nga verifikimi paraprak i bërë nga Shkolla e Magistraturës. Është përgatitur një tabelë përkatëse me 29 (njëzet e nëntë) aplikantë të cilët janë skualifikuar. Janë riparë edhe një herë dosjet me dokumentat e këtyre aplikantëve dhe rezulton që për zotin **Edvin Malotaj** është bërë skualifikimi sepse nuk ka paraqitur një certifikatë të mbrojtjes së gjuhës angleze mbi bazën e testeve ndërkombëtare, kriter që në vlerësimin tim duhet të rishikohet nga Shkolla e Magistraturës për shkak se pjesë e dokumentacionit të depozituar nga ky aplikant është edhe një certifikatë angleze e lëshuar nga Qendra Lincoln, ndërkohë që referuar nenit

11/d të rregullores së shkollës, certifikata e mbrojtjes së gjuhës duhet të jetë lëshuar nga një institucion që është i njohur si i tillë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nisur nga ky parashikim, kam sugjeruar në relacion që për aplikantin, zotin Edvin Malotaj, të bëhet edhe një herë rivlerësimi, duke i vënë në dukje që ekziston një certifikatë e gjuhës angleze e lëshuar nga Qendra Lincoln.

Lidhur me zonjën **Irena Dyrmishi** është bërë edhe një herë një llogaritje, duke marrë parasysh që diferenca ishte shumë e vogël edhe nga tabelat e mesatares së lëndëve kryesore të saj, nga ajo që është e parashikuar si kriter ligjor. Na ka rezultuar që nga një rillogaritje e mesatares së lëndëve kryesore, ajo të jetë 8 dhe në këto kushte kam sugjeruar që Shkolla e Magjistraturës ta rishikojë edhe një herë dokumentacionin e zonjës Irena Dyrmishi, për ta reflektuar edhe këtë në kriterin e mesatares së kërkuar për lëndët kryesore.

Për zotin Lavdosh Shehu, gjithashtu është konstatuar që ai është skualifikuar për shkak përsëri të mesatares së përgjithshme, ndërkohë që duke rivlerësuar mesataren e përgjithshme, përfshirë lëndët e Bachelor-it dhe ato të master-it, ajo ka rezultuar 8.65 dhe në këtë këndvështrim, përsëri është sugjeruar që të rishikohet edhe një herë plotësimi i kriterit ligjor nga ky shtetas. Njëkohësisht, duhet të rivlerësohet edhe eksperiencia e tij e punës, nuk është pasqyruar si kriter nga Shkolla e Magjistraturës, si një kriter skualifikues në fakt nga Shkolla e Magjistraturës, por që nga një llogaritje paraprake rezulton 2.9 muaj. Megjithatë, duke qenë se është shkolla ajo që i vlerëson dhe i rivlerëson kriteret, është bërë edhe ky koment që të rishikohet mesatarja e lëndëve të përgjithshme dhe eksperiencia e punës së zotit **Lavdosh Shehu**.

Lidhur me zonjën **Elisa Zoto**, ka rezultuar që edhe pse ajo kishte përfunduar ciklin e studimeve doktoraturë, motivi i skualifikimit ishte mungesa e certifikatës së anglishtes. I kemi sugjeruar shkollës që ta rikonsiderojë edhe një herë kërkesën e kësaj aplikanteje për t'u futur në provimin e trajtimit fillestar për arsye se pjesë e dokumentacionit të saj ka qenë një certifikatë anglishteje ... dhe për më tepër ligji parashikon që nuk mund të merret titulli Doktor Shkencash pa patur gjuhën e huaj të mbrojtur dhe logjika të thotë që ajo e ka gjuhën e huaj të mbrojtur, kështu që duhet të reflektohet.

Këto janë katër sugjerimet në fakt që janë edhe në relacion.

Ajo çfarë dua të shtroj për diskutim në Këshill, në fakt, në tabelat e përgatitura dhe në sugjerimet e mia nuk pasqyrohet, për shkak se ka qenë e mbështetur në rregulloren e shkollës në fakt, është fakti që për disa aplikantë që janë të pasqyruar në tabelë, shkolla ka bërë skualifikimin referuar nenit 10 të rregullores së saj duke llogaritur përvojën profesionale 3 vjet, pas përfundimit të master-it shkencor. Ndërkohë rezulton që këta aplikantë kanë patur përvojë profesionale pas mbarimit të Bachelor-it dhe nëse do të llogaritej kjo përvojë, pikërisht nga ky moment, deri në momentin e aplikimit, plotësohet kushti 3 vjet. Ligji parashikon që aplikanti duhet të ketë të paktën 3 vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë dhe nuk e përcakton momentin se kur duhet të fillohet të llogaritet kjo përvojë profesionale, ndërkohë që shkolla, në rregulloren e saj, ka përcaktuar si kriter shtesë që koha e përvojës profesionale duhet të fillojë të llogaritet pas përfundimit të plotë të studimeve, përfshirë edhe master-in shkencor (i referohet nenit 10 të rregullores).

Unë do të sugjeroja në fakt që edhe pse kemi një parashikim në rregullore që është ndoshta edhe tej parashikimeve të nenit 28 të ligjit të statusit, është Shkolla e Magjistraturës si autor i vetëm që mund të ndërhyjë ndoshta edhe në rregullore por edhe të rivlerësojë edhe një herë kandidatët për aplikantët që janë skualifikuar për mungesë të përvojës profesionale mbas mbarimit të master-it shkencor, të rivlerësohet situata duke marrë për bazë momentin e mbarimit të Bachelor-it sepse rezulton që të gjithë këta aplikantë kanë punuar në pozicione që lidhen me gjyqësorin si, sekretarë gjyqësor apo specialistë në ZVRPP apo edhe juristë. Ky do të ishte një sugjerim, por që do doja në fakt që ta ndanim edhe në Këshill nëse ka ndonjë mendim tjetër.

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zonja Ukperaj!

Ka ndonjë mendim, koment, sugjerim lidhur me listën e propozuar dhe argumentet e dhëna nga zonja Ukperaj për sugjerimet konkrete që t'i dërgojmë Shkollës së Magjistraturës?

***Maksim Qoku:*** Thjesht për të mbivendosur atë që argumentoi kolegja, sepse mundet që me hapjen e shkollës, e cila është në '97-ën dhe rregullorja duhet të jetë e hershme, procesi i ligjeve, pra hyrja në procesin e Bolonjës, etj., etj., ka ardhur i tillë që edhe ka ndryshuar natyrën e diplomave por edhe që ka shkallët, gradët dhe titujt në lidhje

me kreditet. Çka, si rregull, ligji “Për statusin e nëpunësit civil”, sot mjafton të kesh një Bachelor në drejtësi, mund edhe të rekrutohesh në postet apo pozicione që kërkojnë titullin jurist. Kjo do të thotë që mundet që të gjithë këto persona që nëse përvojën personale dhe profesionale e kanë në sistemin gjyqësor, atëherë mbartin edhe përvojën e punës, prandaj jam edhe dakord që t’i kërkohej Shkollës së Magjistraturës që të azhurnojë aspektin e rregullimit ligjor dhe të rregullores, që kjo e fundit mos të bie ndesh me ligjin. Faleminderit!

**Brikena Ukperaj:** Në fakt, për të saktësuar diçka. Rregullorja e shkollës është miratuar pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të hyrjes së ligjit. Është e vitit 2017. Ligji ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2016.

**Naureda Llagami:** Atëherë, të procedojmë? Ta miratojmë raportin, së bashku me sugjerimet e dhëna nga relatorja e projekt-aktit? Kalojmë për votim miratimin e raportit?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Dakord.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, raporti miratohet sipas përmbajtjes dhe sugjerimeve të dhëna nga zonja Ukperaj, lidhur me komentet dhe kundërshtimet për listën e kandidatëve, të profilit gjyqtar.

**Kalojmë tek çështja e katërt** e rendit të ditës, e cila ka lidhje me: Ndryshimin e vendimit nr. 47, datë 18.03.2019. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, mbështetur në kërkesën e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, propozon një ndryshim lidhur me vendimin nr. 47, datë 18.03.2019, të KLGJ lidhur me caktimin e një gjyqtari në një

gjykatë. Për më shumë informacion, po ia kaloj fjalën kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës, zotit Toska.

***Ilir Toska:*** Faleminderit!

Atëherë, në relacionin që ju keni përpara, janë përshkruar hollësisht të gjitha ato momente faktike për të cilat sot është e nevojshme të bëjmë një ndryshim në vendimin nr. 47, datë 18.03.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kjo sa i përket caktimit të një çështjeje gjyqësore të veçantë, të kërkuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, përmes shkresës së saj nr. 150 protokolli, datë 08.03.2019.

Në rastin konkret kemi bërë një gabim në fakt, nuk kemi pasur parasysh që gjyqtaren që kemi caktuar **Blerta Cibuku**, për shqyrtimin e çështjes konkrete, ka qenë në fakt e caktuar më herët për atë çështje, pra është në përbërje të trupit gjykues dhe do duhet të caktonim një gjyqtar tjetër, pra që të plotësohej treshja e atij trupi gjykues.

Për këtë arsye, mbas njoftimit të bërë nga kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, njoftim ky që ka mbërritur në Këshill më datë 25.03.2019, ju propozojmë që të ndryshohet vendimi nr. 47, datë 18.03.2019, paragrafi i parë, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë”, pika 6, duke caktuar një gjyqtar tjetër nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Ju kemi parashtruar se në rastin ku është bërë caktimi më herët me vendimin nr. 47, propozimet e Komisionit në lidhje me gjykatën nga duhet të caktohej gjyqtari dhe numrin e gjyqtarëve për çështjen konkrete, që ka qenë 1. Ju kemi referuar që në atë rast KLGJ ka pranuar propozimet e Komisionit qoftë për gjykatën qoftë edhe për numrin e gjyqtarëve, sikundër ka pranuar edhe propozimin për përjashtimin e kryetares në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, për përjashtimin nga shorti.

Në këto kushte, duke pasur në konsideratë edhe gjyqtarët e tjerë që janë caktuar tashmë në këtë çështje për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, gjyqtarja e vetme që mbetet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër është gjyqtarja **Mirela Iliopulli**, e cila nëse konsideroni edhe propozimet e mëhershme të pranuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i bie që ta caktojmë për çështjen konkrete, duke ndryshuar në këtë mënyrë vendimin nr. 47, të datës 18.03.2019 sa i përket çështjes gjyqësore penale me kërkues: Prokuroria pra Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, i pandehur: **Razit**

**Halili**, etj., të akuzuar për veprën penale “Prodhim dhe shitje të narkotikëve në bashkëpunim dhe moskallëzim krimi”.

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zoti Toska!

Keni ndonjë pyetje apo koment lidhur me aktin e propozuar?

Atëherë, kalojmë në votimin e aktit sipas propozimit të Komisionit përkatës?

**Maksim Qoku:** Dakord.

*(Zonja Kadi nuk e ka pasur hapur mikrofonin në momentin e votimit. Sipas shënimeve të stenografes, zonja Kadi është dakord propozimit të Komisionit.)*

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

*(Edhe vota e zotit Toro nuk është regjistruar, për shkak se nuk e ka hapur mikrofonin në kohën e votimit. Sipas shënimeve të stenografes, zoti Toro është dakord me propozimin e Komisionit.)*

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Dakord.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit për ndryshimin e pikës 6 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, paragrafi 1 të vendimit nr. 47, datë 18.03.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë mënyrë: “Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër Mirela Iliopulli, caktohet në përbërjen e trupit gjykues, për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, çështjen penale me kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; të pandehur: **Razit Halili, Tori Viktor Ruçi, Kastriot Muka**; akuza: “Prodhim dhe shitje e narkotikëve në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/3 i Kodit Penal (Razit Halili) dhe moskallëzimin e krimit, parashikuar nga neni 300, paragrafi 1 i Kodit Penal (Tori Ruçi dhe Kastriot Muka). Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

**Kalojmë tek çështja e pestë e rendit të ditës.** Edhe lidhur me këtë çështje bëhet fjalë për një ndryshim në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019, të KLGJ, lidhur me caktimin e një gjyqtari në një gjykatë. Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, mbështetur në kërkesën e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, propozon ndryshimin e vendimit të sipërpërmendur. Për më shumë informacion, fjalën ia kaloj sërish zotit Toska, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit.

**Ilir Toska:** Edhe në rastin e vendimit nr. 35 të datës 19 shkurt 2019, në paragrafin e parë, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë”, pika 7, është bërë një gabim në fakt. Në këtë rast është proceduar me një kërkesë të paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë me nr. 173 protokollit, datë 14.01.2019, ku kërkohet caktimi i një gjyqtari për një çështje civile konkrete. Në mbledhjen e datës 19, referuar çështjeve që kishte në nevojë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, kjo çështje është identifikuar me numrin 7 tek listat tabelore. Në atë rast kemi proceduar mbi propozimin e Komisionit që, gjyqtarët që duhet të caktoheshin për çështjet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, të ishte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës. Kemi proceduar edhe për numrin e gjyqtarëve. Në rastin konkret është kërkuar caktimi i një gjyqtari. Propozimi i Këshillit, në atë rast, është marrë në konsideratë dhe janë realizuar procedurat e shortit.

Ndërkohë, në kërkesën e paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, në datën 14 janar 2019, janë evidentuar në mënyrë të përgjithshme gjyqtarët që kanë pasur pengesë ligjore, ku përfshihet edhe zoti **Erjon Çela**. Ndërkohë që në parashtrirat më të hollësishme, për komentet që kishte rreth faktit të pengesave ligjore, sa i përket gjyqtarit **Erjon Çela**, nuk është bërë një evidencë e tillë. Kjo ka çuar më pas në gabim Këshillin e Lartë Gjyqësor që përmes procedurave të shortit ka caktuar gjyqtarin Erjon Çela, i cili në atë moment ka qenë i transferuar përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, që të gjykojë për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen civile për të cilën është kërkuar nga kryetari i gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë me shkresën e datës 14 janar 2019.

Pas kësaj, mbasi është njoftuar për këtë vendim edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, tashmë gjyqtari i transferuar përkohësisht Erjon Çela është rikthyer përsëri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe ka bërë me dije Këshillin se ka pengesë ligjore

për këtë çështje ku ai është caktuar me vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi ai edhe më herët ishte caktuar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë për gjykimin e kësaj çështjeje, kishte paraqitur dorëheqjen dhe dorëheqja ishte miratuar më datë 28 dhjetor 2018 nga kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Me ardhjen në dizeni të kësaj rrethane të re të parashtruar nga kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, po ju parashtrojmë që jemi në kushtet e ndryshimit të vendimit nr. 35, pika 7, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë”, paragrafi i parë i vendimit nr. 35, datë 19.02.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket gjyqtari që duhet të caktohet, duhet të organizojmë duke pranuar faktin që kemi rënë dakord që gjykata nga duhet të caktojmë gjyqtarin, duhet të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës. Ne duhet të realizojmë një procedurë shorti mes dy gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, konkretisht gjyqtarja **Alma Ahmeti dhe Rexhep Karaj**, njëri prej të cilëve duhet të caktohet për të gjykuar çështjen civile konkrete që u përket palëve **Nuredin Haxhiaj**, i paditur: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, me objekt: “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv”.

Nëse jeni dakord me këtë propozim do të duhet të realizojmë një procedurë shorti dhe në përfundim të vendosim ndryshimin e vendimit nr. 35, datë 19.02.2019.

**Naureda Llagami:** Atëherë, jemi dakord me propozimin e bërë nga Kryetari i Komisionit lidhur me hedhjen e procedurës së shortit ndërmjet dy gjyqtarëve Alma Ahmeti dhe Rexhep Karaj?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Dakord.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.



Atëherë të vijohet me hedhjen e procedurës së shortit ndërmjet këtyre dy gjyqtarëve.

**Valbona Bako:** Alma Ahmeti.

**Ilir Toska:** Pas shortit të hedhur, rezulton që gjyqtarja që u përzgjedh nga shorti është gjyqtarja Alma Ahmeti. Referuar këtij fakti, duhet të ndryshojmë pra vendimin nr. 35, datë 19.02.2019, në pikën 7, paragrafi i parë, nënndarja ‘Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë’, duke caktuar gjyqtaren Alma Ahmeti në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë çështjen civile me palë paditëse Nuredin Haxhiaj, i paditur: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, me objekt: “Pavlefshmëri titulli ekzekutiv fatura tatimore e shitjes së energjisë elektrike, et.”

**Naureda Llagami:** Jeni dakord me propozimin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi ndryshimin e pikës 7 “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë”, paragrafi 1 i vendimit nr. 35, datë 19.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor: “Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, që caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë është zonja Alma Ahmeti, me palë paditëse: Nuredin Haxhiaj, të paditur: Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, me objekt: “Pavlefshmëri të titujve ekzekutiv, fatura tatimore të shitjes së energjisë elektrike”. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

**Kalojmë tek pika tjetër e renditë** të ditës, e cila sikurse ju vura në dijeni, ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, **Flora Hasimi**, për përfitimin e lejes së papaguar, për një periudhë kohore 4-5 javore nga ushtrimi i detyrës së gjyqtares për shkaqe shëndetësore, duke filluar nga 5 prilli 2019 deri më datë, jo më larg se 18 maj 2019.

Sikurse jeni në dijeni, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është depozituar kërkesa e gjyqtares Flora Hasimi, e cila kërkon shkëputje të përkohshme nga ushtrimi i detyrës së gjyqtares.

Për më shumë detaje lidhur me këtë projekt-akt, ia jap fjalën relatores së projekt-aktit, zonjës Brunilda Kadi.

**Brunilda Kadi:** Faleminderit!

Siç u relatua dhe keni dijeni nga aktet, nga gjyqtarja në fjalë është bërë kërkesa me shkrim në datën 18.03. pranë Këshillit, ku kërkon leje të papaguar, për arsye shëndetësore, për periudhat që u cituan, domethënë 4-5 javore dhe ajo referon datën 5 prill dhe datat e mundshme të përfundimit 13-18 maj. Siç e keni të shkruar tek relacioni që jeni vënë paraprakisht në dijeni, kjo kërkesë është trajtuar në bazë të ligjit, nenit 24, paragrafi 3, i ligjit “Për statusin...”, pasi pavarësisht se ligji autorizon Këshillin për të bërë rregullore dhe për të detajuar rregullat, nga ana e Komisionit të Etikës dhe Vlerësimit Profesionale është bërë puna paraprake, është bërë një draft i lejes, i është çuar misioneve për mendim, edhe ende nuk është kthyer, kështu që prandaj nuk jemi në kushtet e një rregulloreje të miratuar dhe për këtë arsye, trajtimi i kësaj është bërë direkt nga dispozitat e ligjit që u citua.

Kërkesa është bërë më shkrim. Bashkëngjitur saj është edhe një dokument, një autorizim nga një mjek i një shteti tjetër. Kërkesa është në gjuhën gjermane, e përkthyer nga një përkthyes (siç e keni të gjithë një kopje të saj). Dhe nga ana ime si relatores është vlerësuar që kjo kërkesë është në përputhje me ligjin, arsyet që ajo parashtron janë shëndetësore dhe emergjente dhe në fakt, për shkak të kësaj natyre nuk është marrë dhe paraprakisht formalisht mendim nga kryetari i gjykatës sepse koha që kërkohet e shkëputjes, pra përveç faktit që është emergjente, është e shkurtër dhe vlerësohet që s’mund të cenojë punën e gjykatës. Edhe interesi i gjyqtarit në këtë rast vlerëson që

prevalon mbi këtë. Është propozuar projektvendimi që ju është vënë në dispozicion, për t'i dhënë lejen e papaguar për arsye shëndetësore nga data 5 prill 2019 deri më 18 maj 2019. Bashkëngjitur keni aktet. Faleminderit!

**Naureda Llagami:** Faleminderit, zonja Kadi!

Ka njeri ndonjë koment, sugjerim apo diskutim për çështjen? Jo!

Atëherë, kalojmë projekt-aktin, sipas propozimit të bërë nga relatorja, në votim?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ilir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: T'i japë leje të papaguar gjyqtares Flora Hasimi, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për periudhën kohore 5 prill 2019 deri më 18 maj 2019. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kalojmë tek çështja tjetër e rendit** të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”. Ashtu sikurse jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 31, datë 14.02.2019 ka ngritur një Komision të përkohshëm i cili do të trajtojë dhe shqyrtojë të gjitha ankimet kundër vendimit të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës, pas shqyrtimit fillestar, kundër vendimit për arkivimin e ankesës pas verifikimit shtesë të saj, si dhe kundër vendimit për mbylljen e hetimit ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit. Krijimi i këtij Komisioni është bërë mbështetje të nenit 62, pikat 13, 14 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e

qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Një nga pikat që ishte parashikuar në vendimin e sipërcituar nga ana e Këshillit ishte që, për funksionimin e këtij Komisioni, ky Komision duhet të miratonte, duhet të propozonte dhe Këshilli të miratonte disa rregulla për organizimin dhe funksionimin e tij.

Për më shumë, fjalën ia kaloj zonjës Fatmira Luli, e cila është edhe relatorja e projekt-aktit.

**Fatmira Luli:** Atëherë, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 31, datë 14.02.2019 është vendosur ngritja e Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari. Me këtë vendim janë miratuar edhe disa rregulla për ushtrimin e dhe funksionimin, rregulla të përgjithshme për kompetencën e këtij Komisioni, i cili do shqyrtojë të tëra ankimet e regjistruara në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të cilat janë 183 (njëqind e tetëdhjetë e tre) ndaj vendimeve të Kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilat janë depozituara në protokollin e këtij institucioni të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe presin për t’u shqyrtuar nga Komisioni i cili ligji 115/2016 ka përcaktuar në nenin 62 kompetencën që Komisioni i përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të Kryeinspektorit të krijohet me dy anëtarë jo gjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar. Përbërja e tij caktohet me short dhe vendimet e këtij Komisioni janë vendime të formës së prerë.

Në këto kushte, Komisioni, në mbledhjen e tij të parë u mbledh dhe shqyrtoi detyrimin ligjor që buron nga vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe nga ligji dhe miratoi rregullat bazë për funksionimin e tij, bazuar edhe në ligjin 115 dhe në dispozitat në ligjin “Për statusin e gjyqtarit”, dispozitat referuese.

Në këtë rregullore u konsideruan për t’u përcaktuar ‘Objekti – qëllimi kryesor i kësaj rregulloreje’, ‘Afati në të cilën do të shtrihet veprimtaria e këtij Komisioni’, ‘Fusha e veprimtarisë së Komisionit’, meqenëse ky Komision ka një kompetencë të rëndësishme vendimmarrjeje e cila është e paapelueshme, mënyra se si anëtarët e Komisionit do shqyrtojnë dhe do marrin në shqyrtim të tëra ankesat e depozituara të bëra kundër vendimeve të Kryeinspektorit, e cila do të jetë me short, për të qenë të paanshëm dhe të

bazohet në parimet e transparencës, paañësisë dhe pavarësisë, si dhe mënyrën se si relatohet, mënyrën se si drejtohet Komisioni nga kryetari dhe mënyra se si merret vendimmarrja në Komision. Gjithashtu është pasur në konsideratë, dispozitat e konfliktit të interesit, që përcakton neni 72, 73, 74, 75 i ligjit “Për statusin e gjyqtarit” dhe ligjit “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, për përjashtimin ose heqjen dorë të njërit prej anëtarëve të Komisionit në rastet kur ai konstaton se ka pengesë ligjore për ta shqyrtuar, janë tre raste që parashikon neni 72 i ligjit 115: a) të deklarojë natyrën e interesit; b) të mos marrë pjesë në diskutimin e çështjes; c) të mos marrë pjesë në votimin e çështjes. Në këto rrethana, është parë e domosdoshme që, krahas miratimit të këtyre rregullave, në këtë mbledhje të miratohen edhe anëtarët zëvendësues të cilët në rast se dy anëtarë ose një anëtar i këtij Komisioni ka një pengesë ligjore për të shqyrtuar një ankesë, të heqë dorë dhe të futet në votim dhe në diskutim anëtari zëvendësues i këtij Këshilli.

Por meqenëse... Këto parime janë miratuar në rregullore. Pika tjetër është por unë po flas për rregulloren, përmbajtjen e rregullores.

Në këto kushte, ftoj Komisionin që të miratojë rregulloren dhe pastaj të hedhim në votim edhe sipas shortit të përcaktuar në ligj, në rregulloren e mëparshme, short me fleta edhe anëtarin zëvendësues. Meqenëse ne kemi vetëm dy anëtarë zëvendësues, bëhet fjalë për anëtarët zëvendësues që janë jo gjyqtarë, që vijnë nga avokatia ose nga pedagogët, ne jemi vetëm dy, se kryetari s’futet në këtë Komision, atëherë i bie që (edhe Erjonin s’e kemi prezent sot), i bie që të futen në short... do jeni vetëm ju me Erjonin dhe Maksi duhet ta tërheqë i pari sepse Erjoni s’është prezent. Kështu që... Në këto kushte, miratojmë njëherë rregulloren dhe pastaj kalojmë në votimin e anëtarit zëvendësues.

**Naureda Llagami:** Atëherë, faleminderit zonja Luli!

Për të qenë më të saktë, çështja që kemi për votim dhe për diskutim është fillimisht rregullorja, më pas është çështja tjetër lidhur me caktimin e anëtarëve zëvendësues për komisionin përkatës.

Lidhur me përmbajtjen e rregullores së propozuar nga Komisioni dhe relatorja, keni ndonjë diskutim?

**Medi Bici:** Vetëm një saktësim.

...duhet të filloheshin nga dispozitat kushtetuese, burimi sipër?

**Naureda Llagami:** Dakord, këto janë gjëra që mund t'i rregullojë në zbardhjen e vendimit stafi administrativ.

Lidhur me përmbajtjen e rregullores, ta kalojmë për votim? Kemi komente për nenet konkrete? Atëherë, po hedhim në votim propozimin e bërë nga relatorja, zonja Luli.

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

*(Zonja Luli nuk e ka ndezur mikrofonin në momentin e votimit. Sipas shënimeve të stenografes, zonja Luli është dakord me rregulloren.)*

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi Miratimin e “Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të kryeinspektorit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari”, sipas tekstit bashkëlidhur të këtij vendimi, të propozuar nga relatorja, zonja Luli. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Sikurse u relatua paraprakisht** nga zonja Luli, po me kërkesë të Komisionit përkatës është propozuar Këshillit edhe hedhja dhe caktimi i dy anëtarëve zëvendësues, në rastet që ky Komision mund të ndodhet përpara konfliktit të interesit. Në këtë logjikë është propozuar projekt-akti: Shqyrtimi i projektvendimit për caktimin e anëtarit zëvendësues në Komisionin e përkohshëm për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimit të Kryeinspektorit për arkivimin e ankesës ose pushimin e hetimit. Ky projekt-akt është hartuar dhe propozohet serish nga zonja Luli.

Fjalën e ka zonja Luli për propozimin e projekt-aktit!

**Fatmira Luli:** Me vendimin 32, datë 14.02.2019 Komisioni, bazuar në vendimin 31, ka bërë shortin dhe ka caktuar anëtarët e Komisionit për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Kryeinspektorit, zotërinjtë Dritan Hallunaj, Alban Toro dhe Fatmira Luli. Meqenëse edhe gjatë shikimit të ankesave të cilat i bashkëngjiteshin atij projekt-akti, ne konstatuam që kishim persona për të cilët... nga dy anëtarët jo gjyqtarë kishim raste të konfliktit të interesit dhe të pengesës ligjore për të marrë në shqyrtim, u pa e domosdoshme që krahas miratimit të rregullave, duhet të përcaktoheshin edhe anëtarët zëvendësues meqenëse në mbledhjen e kaluar nuk u përcaktuan, të përcaktohen edhe anëtarët zëvendësues në rast konflikti interesi, që do të zëvendësonin dhe do të bënin vendimmarrjen e plotë sepse Komisioni, sipas rregullores shqyrton të tëra këto ankime me anëtarësi, me tre anëtarë dhe ai është kuorumi i domosdoshëm për të marrë vendimmarrjen. Në rast të mungesës së një anëtari Komisioni do ngelesh pa vendimmarrje.

Në këto kushte parashikuam dhe i propozuam këtij Këshilli të shqyrtojë dhe të zgjedhë me short dy anëtarët zëvendësues, që në fakt janë edhe dy anëtarët e mbetur të Këshillit Gjyqësor, zotërinjtë Maks Qoku dhe Erjon Muharremaj.

Shorti do bëhet në një vazo me gogla, siç u bë procedura e mëparshme, ku do shënohen 'Anëtar zëvendësues' dhe 'Anëtar jo zëvendësues'. Kështu që me të njëjtën procedurë do të kalohet.

*(Nga salla e mbledhjes pyetet përse mos të bëhet edhe për gjyqtarët.)*

Atëherë, duhet ta bëjmë kështu. Një anëtar zëvendësues dhe një gjyqtar, një anëtar gjyqtar. Zëvendësues është... sepse rregulli është që në qoftë se largohet një anëtar që është jo gjyqtar, ai do zëvendësohet nga një i tillë. Në qoftë se largohet për shkak të pengesës ligjore një anëtar gjyqtar, do zëvendësohet. Kështu që të bëhet për të dyja rastet, që të ketë nga një anëtar zëvendësues.

**Naureda Llagami:** Të vijojë procedura për hedhjen e shortit. Fillimisht të vijojë procedura për hedhjen e shortit për anëtarët jo gjyqtarë.

**Elis Kuçi:** Për anëtarët jo gjyqtarë janë dy gogla. Një anëtar dhe një jo anëtar zëvendësues.

**Naureda Llagami:** Atëherë, përpara se të kalojmë tek hedhja e goglës, i propozoj Këshillit hedhjen për votim të projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatorja zonja Luli dhe më pas vazhdimin e procedurës së hedhjes së goglave, lidhur me përcaktimin e anëtarëve zëvendësues.

Kalojmë projekt-aktin?

**Maksim Qoku:** Dakord.

**Brunilda Kadi:** Pro.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Illir Toska:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Pro.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Medi Bici:** Pro.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli miraton projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga relatori, nga Komisioni.

Kalojmë në procedurën e hedhjes së goglës.

*(Përzgjedh anëtari Maksim Qoku, pasi zoti Muharremaj nuk është prezent në mbledhje.)*

**Maksim Qoku:** Jo anëtar zëvendësues.

**Elis Kuçi:** Gogla tjetër është ‘Anëtar zëvendësues’.

**Naureda Llagami:** Atëherë, pas hedhjes së shortit, anëtari zëvendësues nga radhët e jo gjyqtarëve është zoti Erjon Muharremaj.

Kalojmë në hedhjen e shortit për anëtarin zëvendësues nga radhët e gjyqtarëve.

**Elis Kuçi:** Janë 5 gogla.

**Fatmira Luli:** Në këtë short përjashtohet Dritani, që është anëtar i këtij Komisioni dhe janë të tërë të tjerët.

*(I pari që përzgjedh është zoti Medi Bici.)*

**Elis Kuçi:** Anëtar, zoti Medi Bici.



*Naureda Llagami:* Atëherë, anëtari zëvendësues nga radhët e gjyqtarëve është zoti Medi Bici.

Nëse nuk kemi ndonjë çështje tjetër për të diskutuar, unë mbledhjen e sotshme e konsideroj të mbyllur. Faleminderit për pjesëmarrjen! Faleminderit edhe të gjithë përfaqësuesit e organizatave që kanë ardhur këtu për monitorimin e mbledhjes.

\* \* \*

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**Kryetare**

**Naureda Llagami**

**Redaktore-Stenografe**

**Rosalba Xhabrahimi**